



Cendra e Trajnimeve & Burimeve për Avokim

AVOKUESI



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA

Perkrah
komunitetin e OJQ-ve



Vëllimi V • Numri 2 • Shkurt 2007

PËRMBAJTJA

Faqe 2

ATRC-ja shpalli rundin e pestë të Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim

Shoqëria civile bën thirrje për hetim të besueshëm dhe transparent të protestës

"Përhapja e Dhunës në Baza Gjinore në Rajonin e Pejës"

Libri Shqiptar i Politikave

Faqe 3

Koalicioni i Grave për Paqe i ka dërguar letër Martti Ahtisaarit

"Qeveria duhet t'i stimulojë qytetarët për të paguar taksat"

Universiteti Veror Ndërkombëtar i Prishtinës 2007

Faqe 4

Shoqata Evropiane për Arsimimin e të Rriturve ndihmon OJQ-të të punojnë së bashku

Koalicioni i OJQ-ve harton strategji për bashkëpunim të qeverinë e Malit të Zi

Shteti dhe OJQ-të në procesin e anëtarësimit në BE

Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së: www.advocacy-center.org

Rr. Agim Ramadani Nr. 15
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244 810

ATRC-ja u ofron mundësi qytetarëve të Kosovës të informohen për pakon e Ahtisaarit

ATRC-ja në bashkëpunim me tridhjetë OJQ vendore do të organizoj tryeza të rrumbullakëta në 30 komuna të Kosovës dhe shtatë takime rajonale gjatë muajve mars dhe prill, me qëllim të informimit të qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile për përmbytjen e propozimit për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Këto takime publike janë mundësi për qytetarët që të informohen, shqetësimet e tyre të dëgjohen, dhe të shtrojnë pyetje për propozimin e Martti Ahtisaarit, përfaqësues i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së

për negociatat për statusin e ardhshëm të Kosovës.

Ahtisaari bëri publike paketë propozimin e tij më 2 shkurt, pas një viti negociatash në Vjenë të Austrisë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Panelistët pjesëmarrës në tryezat e rrumbullakëta të organizuara nga ATRC-ja do të jenë individë me ekspertizë për pakon. Përfaqësues të qeverisjes lokale dhe qendrore, OJQ-ve, media dhe bizneseve gjithashtu do të marrin pjesë në këto takime.

"Synimi i Propozimit të Gjithanshëm për Marrëvesh-

jen mbi Statusin e Kosovës është të përcaktojë kërkesat e nevojshme për një Kosovë të ardhshme të qëndrueshme dhe stabile. Ai përfshin masa të hollësishme për të siguruar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, decentralizim të efektshëm të qeverisë, dhe ruajtjen e mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare", thuhet në përmbledhjen ekzekutive të propozimit të Ahtisaarit për statusin.

Për të lexuar propozimin e plotë, vizitoni www.uno-sek.org



Ahtisaari i paraqiti propozimin e tij Ekspit të Unitetit të Kosovës më 2 shkurt

ATRC trajnon OJQ-të për shkrim të projekt propozimeve

Trajnerët e ATRC-së kanë mbajtur trajnim për shkrim të projekt propozimeve më 26-27 shkurt, në të cilin morën pjesë përfaqësues të OJQ-ve vendore të interesuar për të aplikuar për rundin e pestë të granteve për partneritet dhe rrjetëzim të IREX Programit Kosovovar për Shoqërinë Civile. Trajnimi u ofroi njohuri pjesëmarrësve për zhvillimin e projekteve nga idetë fillestare deri tek përpilimi i qëllimeve dhe synimeve, buxhetit, si dhe planeve për implementim të propozimit.

Trajnimi është organizuar në kuadër të workshop-eve për këtë vit, të cilat janë të hapura për të gjitha OJQ-të kosovare të regjistruara si klientë të ATRC-së. Ato OJQ të interesuara për shërbimet e ATRC-së (falas për OJQ-të kosovare), e që nuk janë regjistruar mund ta plotësojnë formën e regjistrimit në www.advocacy-center.org.

Për më shumë informata, kontaktoni training@advocacy-center.org

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Publikime

"Përhapja e Dhunës në Baza Gjimore në Rajonin e Pejës"

Qendra për Mirëqenie të Gruas në Pejë ka publikuar më 12 shkurt një hulumtim mbi përhapjen e formave të ndryshme të dhunës në baza gjimore në rajonin e Pejës. Hulumtimi është kryer në gusht të vitit 2002 dhe përfshinë rezultatet e nëntë fshatrave të rajonit të Pejës.

Për raportin e plotë, kontaktoni pejawwc@yahoo.com

Libri Shqiptar i Politikave

Vëllimi për vitin 2006 i Librit Shqiptar të Politikave është publikuar më 8 shkurt dhe përfshinë çështje gjimore, historike, politike dhe të migracionit të shoqërisë shqiptare. Libri është përqendruar në identitetin evropian të shqiptarëve dhe në Evropën Juglindore si rajon historik. Libri Shqiptar i Politikave është publikim akademik i Shoqatës Shqiptare të Shkencave Politikave. Qëllimi i Librit është sigurimi i një forumi akademik për studim të politikave dhe shoqërisë shqiptare.

Për më shumë informata, vizitoni <http://ajp.alpsa.org>.

Burimi: Balkan Academic News

Mundësi financimi për OJQ-të**ATRC-ja shpalli rundin e pestë të Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim**

ATRC-ja më 17 shkurt ka shpallur konkurs për OJQ-të kosovare për rundin e pestë të Granteve për Partneritet dhe Rrjetëzim në kuadër të Programit Kosovar për Shoqërinë Civile të IREX-it.

Grantet për Partneritet dhe Rrjetëzim do t'u ndahen OJQ-ve, projekt-propozimet e të cilave përmbajnë komponentë të fuqishëm partneriteti dhe rrjetëzimi ndërmjet OJQ-ve, OJQ-ve dhe sektorëve të tjerë (qeveria lokale ose qendrore, bizneset private). Projektet po ashtu duhet të adresojnë çështje të rëndësishme në njërën prej këtyre tri fushave: transparenca dhe anti-korrupsioni,

zhvillimi i komunitetit ose pajtimi ndëretnik, dhe zgjidhja e konfliktit. Kohëzgjatja e këtyre granteve është 6-9 muaj. OJQ-të mund të aplikojnë për grant deri në \$ 25,000. Afati i fundit për dorëzim të projekteve është 15 marsi, 2007.

Dokumentet gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të konkursit (përfshirë përshkrimin e programit, kriteret e ndarjes së granteve, afatet kohore për aplikim, kriteret e përzgjedhjes dhe procesi i shqyrtimit, format e kërkuara për aplikim si dhe formati dhe udhëzuesi i propozimit) mund të merren në ATRC, rruga Agim Rama-

dani, Nr.15, Prishtinë ose të shkarkohen nga faqja e Internetit e ATRC-së www.advocacy-center.org.

Programi Kosovar për Shoqëri Civile (KCSP) është iniciativë trevjeçare e financuar nga USAID dhe e realizuar nga IREX. Qëllimi i programit është zhvillimi i mëtejshëm i shoqërisë civile dhe komunitetit të OJQ-ve në Kosovë, që të jetë sektor i qëndrueshëm dhe të luaj rol domethënës në përfaqësimin e dallimeve qytetare si dhe në formulimin e politikave publike.

Për më shumë informata, kontaktoni 038 244 810 ose grants@advocacy-center.org.

Reagimi i shoqërisë civile ndaj protestës së dhunshme në Prishtinë më 10 shkurt**Shoqëria civile bën thirrje për hetim të besueshëm dhe transparent të protestës**

Protesta e dhunshme në Prishtinë më 10 shkurt

Përfaqësues të shoqërisë civile diskutuan për protestën e organizuar më 10 shkurt në Prishtinë nga lëvizja Vetëvendosja. Dy protestues vdiqën nga lëndimet pasi policia sulmoi me gaz lotsjellës dhe plumba gome për të ndaluar një turmë të drejtuar drejt ndërtesave qeveritare. Pasojat e kësaj proteste janë shqyrtuar më 14 shkurt gjatë një tryeze të rumbullakët të organizuar

nga "Iniciativa Qytetare". Tryeza synonte iniciimin e debatit publik për dhunën e policisë ndaj protestuesve. Diskutimi u përqendrua në reagimin e policisë në protestë; transparencën e komisionit hetues; dhe kush duhet të marrë përgjegjësi për vdekjen e dy protestuesve.

Ata kërkuar që përfaqësues të Zyrës së Ombudspersonit dhe shoqërisë civile të përfshihen në komisionin hetues në mënyrë që të garantohet kredibiliteti i raportit.

"Ngjarjet e tilla nuk po marrin reagimin e merituar, posaçërisht nga sektori i tretë, shoqëria civile", ka dekla-

ruar publicisti Shkëlzen Maliku. Pjesëmarrësit konkluduan se:

Vdekja e dy qytetarëve, plagosja e dhjetëra protestuesve dhe reagimi jo proporcional i forcave të sigurisë dëmtojnë përpjekjet e ndërtimit të një shoqërie demokratike që respekton të drejtat e njeriut.

Hetimet e iniciuara nga institucionet qeveritare duhet të identifikojnë përgjegjësinë e vendim marrësve, përgjegjës për sigurinë në Kosovë.

Qeveria e Kosovës, UNMIK-u dhe vendim marrësit e tjerë përgjegjës për siguri duhet menjëherë të ndalojnë përdorimin e plumbave të gomës nga policia ...

Për letrën e plotë, kontaktoni: initiativeqytetare@gmail.com

Shkollim

Universiteti Veror Ndërkombëtar i Prishtinës 2007

Universiteti i Prishtinës i përkrahur nga Shoqata Akadematike për Trajnime do të organizoj edicionin e 7-të të Universitetit Veror të Prishtinës prej 16 korrikut deri më 3 gusht 2007.

Kandidatët e interesuar për të ndjekur këtë universitet veror mund të regjistrohen tash për tu informuar për procedurën e aplikimit. Për tu regjistruar, vizitoni: http://www.stuc.uva.nl/ata/student/registration/prereg.a.sp?inpSU_id=1

Universiteti Veror i Prishtinës për këtë vit ofron 15 kurse akademike në fushën juridike, ekonomike, filozofike, të artit, mjekësisë, matematikës, inxhinierisë mekanike, shkencave sociale, edukatës fizike, etj. Pjesëmarrësit do të shpërblehen me certifikata, të cilat përbajnë ECTS kredi. Pjesëmarrja është falas!

Për më shumë informata, vizitoni: www.uni-pr.edu ose www.academictraining.org.

Burimi: *Balkan Academic News*



Koalicioni i Grave për Paqe i ka dërguar letër Martti Ahtisaarit

"Në përkrahje të një zgjidhjeje të drejtë dhe të qëndrueshme për Kosovën"

Koalicioni i Grave për Paqe më 12 shkurt i ka dërguar Martti Ahtisaarit, të dërguarit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për negociatat për statusin e ardhshëm të Kosovës, një letër në përkrahje të pavarësisë së Kosovës. Letra është nënshkruar nga Rrjeti i Grave të Kosovës dhe Rrjeti i Grave në të Zeza nga Serbia të cilat kanë themeluar Koalicionin e Grave për Paqe në mars të vitit 2006 si iniciativë e pavarur qytetare.

Në letër thuhet: *Gratë nga Kosova dhe Serbia kanë themeluar Koalicionin e Grave për Paqe për të monitoruar bisedimet për statusin përfundimtar politik të Kosovës. Me intensifikimin e përpjekjeve për zgjidhjen e statusit të ardhshëm të Kosovës, besojmë se është e domosdoshme t'ju përkujtojmë juve, ekipëve negociatorë, dhe ko-*

munitetit ndërkombëtar disa çështje shumë të rëndësishme.

Së pari, statusi i ardhshëm i Kosovës duhet të zgjidhet duke marrë parasysh vullnetin e popullatës s h u m i c ë shqiptare. Rruga e Kosovës drejt integritit evropian duhet të kalojë jashtë kufijve të shtetit serb, dhe duhet të përfshijë mbrojtjen e plotë të të drejtave të njeriut, individuale dhe kolektive për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe Serbisë.

Së dyti, lokalitetet kulturore nuk duhet të shfrytëzohen si mjete politike drejt homogjenizimit të komuniteteve në Kosovë. Kjo do të shpie drejt izolimit dhe ndarjes së ko-



Koalicioni i Grave për Paqe nga Kosova dhe Serbia i ka dërguar letër Ahtisaarit më 12 shkurt në përkrahje të pavarësisë së Kosovës

muniteteve, gjë që do t'i kontribuonte dhunës në të ardhmen. Në vend të kësaj, lokalitetet kulturore duhet të konsiderohen pjesë e një historie heterogjene që i përket të gjitha grupeve etnike dhe duhet të shfrytëzohet për të promovuar pronësi të trashëgimisë ndërkulturore të të gjitha komuniteteve sikurse edhe të ardhmes së tyre të përbashkët ...

Për të lexuar letrën e plotë, vizitoni: www.womensnetwork.org.

Debat publik i iniciuar nga OJQ-të

"Qeveria duhet t'i stimuloj qytetarët për të paguar taksat"

Përfaqësues të OJQ-ve, mediave dhe sektorit të biznesit janë mbledhur në ATRC më 16 shkurt për të shqyrtuar rolin e qytetarëve ndaj taksave publike në një tryeze të rumbullakët të organizuar nga OJQ "Mileniumi i Ri".

Diskutimet në këtë tryezë u përqendruan në ndikimin që taksat e qytetarëve kanë në qëndrueshmërinë buxhetore, zhvillimin e përgjithshëm dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve publike.

"Qytetarët e Kosovës nuk janë në dijeni për rëndësinë e pagimit të taksave



Përfaqësues të OJQ-ve, mediave dhe biznesit shqyrtuan rolin e qytetarëve ndaj taksave publike më 16 shkurt

në mënyrë që të sigurohet sistem i qëndrueshëm dhe efikas buxhetor", ka deklaruar Sakip Imeri, zëvendës drejtor i Administratës Tatimore të Kosovës. Ai u bëri thirrje qytetarëve t'i paguanë taksat "sepse investimet kapitale financohen

nga taksat publike".

Lumir Abdixhiku nga "Instituti Riinvest" kritikoi qeverinë për politikë të gabueshme fiskale. "Qeveria nuk ka iniciuar ndonjë projekt që do t'i stimulonte qytetarët për t'i paguar taksat", ka thënë ai. Përfaqësues të shoqërisë civile veçuan se shërbime më të mira publike do të shtonin numrin e tatim paguesve. Sipas tyre, për mbledhjen e taksave nevojitet qeverisje e mirë. Kjo tryezë është përkrahur nga ATRC-ja.

Për më shumë informata, kontaktoni: ojqmileniumi@yahoo.com

atrc**Executive Director**
RREZE DULI
rreze@advocacy-center.org**Financial & Administration
Manager**
GANI ASLLANI
gani@advocacy-center.org**Grant Manager**
TEUTA LUZHA
teuta@advocacy-center.org**Grant Officer**
KUSHTRIM KALOSHI
kushtrimk@advocacy-center.org**Grant Officer**
XHAFAER AHMETI
xhafer@advocacy-center.org**Grant Finance Manager**
SAFETA XHEKOVIC
safeta@advocacy-center.org**Training & Consultancy
Services Manager**
DONIKA SALIHU
donika@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**
AFERDITA SURROI
aferdita@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**
KUSHTRIM ISLAMI
kushtrim@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**
NORA SUSURI
nora@advocacy-center.org**Communication & Outreach
Manager**
ARJETA DOROCI
arjeta@advocacy-center.org**Program Officer**
NATYRA ZHJEQI
natyra@advocacy-center.org**IT and Database Manager**
ARSIM KOSUMI
arsim@advocacy-center.org

Education

Shoqata Evropiane për Arsimimin e të Rriturve ndihmon OJQ-të të punojnë së bashku

Shoqata Evropiane për Arsimimin e të Rriturve (EAEA) është OJQ evropiane me 114 organizata anëtare nga 41 vende të cilat punojnë në fushën e arsimit të të rriturve. EAEA avokon për arsimimin e të rriturve dhe për OJQ-të që punojnë në këtë fushë. Kjo shoqatë organizon seminare informativ për të ngritur vetëdijen për programet e BE-së dhe politikat zhvillimore. EAEA po ashtu organizon trajnime për burimet e financimeve evropiane për arsimimin e të rriturve. EAEA promovon zhvillimin e arsimit tek të rriturit në nivel evropian dhe lobon tek trupat ndërkombëtar që ata të miratojnë plane dhe politika që iu përshtaten nevojave të popullatës së rritur në Evropë. Ajo nxit bashkëpunimin në Evropë dhe ndihmon OJQ-të të punojnë së bashku dhe të luajnë rol aktiv në skenën ndërkombëtare. Qëllimet kryesore të kësaj shoqate janë avokimi për politikat



EAEA avokon për arsimimin e të rriturve dhe për OJQ-të që punojnë në këtë fushë

e arsimit në nivel evropian: publikimet dhe trajnimet; bashkëpunimi ndërkombëtar; etj


EAEA Eastern Europe Link Office: Katalin Varga (kontakt personi); Budapest, Hungari; e-mail: mnt@nepfoiskola.hu

Për më shumë informata, vizitoni: www.eaea.org
Burimi: EAEA

Bashkëpunim OJQ/qeveri

Koalicioni i OJQ-ve harton strategji për bashkëpunim me qeverinë e Malit të Zi

Koalicioni i OJQ-ve "Bashkëpunimi për Qëllim të Përbashkët" ka përgatitur në dhjetor draftin Strategjia e Marrëdhënieve ndërmjet Qeverisë dhe OJQ-ve në Mal të Zi. Ky koalicion ka përgatitur po ashtu "Kodin e Mirësjelljes për OJQ" dhe "Strukturën e Financimit Publik për OJQ-të". Këto dokumente mund të lexo-



Podgorica, Mali i Zi

hen në web faqen e koalicionit: <http://www.koalicionjanvo.cg.yu/>

"Bashkëpunimi për Qëllim të Përbashkët" është formuar në maj 2006 për të themeluar mekanizma institucional për bashkëpunim ndërmjet OJQ-ve dhe qeverisë.

Burimi: Një Botë Evropa Juglindore

Publikim i ri

Shteti dhe OJQ-të në procesin e anëtarësimit në BE

Shoqata Alumni e Qendrës për Studime Post Diplomate në Sarajevë, Bosnjë, ka publikuar në shkurt rezultatet e një hulumtimi për rolin e sektorit të OJQ-ve në proceset integruese të Bosnjës, Kroacisë dhe Serbisë në BE.

Ky publikim është titulluar "Shteti dhe OJQ-të në Procesin e Anëtarësimit të Kroacisë, Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinë në BE: përmes partneritetit deri te suksesit".

Ai mund të shkarkohet nga: <http://www.acips.ba/TheStateandNGO.pdf>

Burimi: Balkan Academic News